



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1230/4 Prot

Tiranë, më 26/10/2020

**VENDIM**

Nr. 48, datë 26.10.2020

**PËR**

**RRËZIMIN E ANKESËS**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1230 Prot., datë 12.10.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës së datës 10.09.2020, depozituar në portalin *pyetshtetin.al*, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *A është përfunduar procesi i auditimit të zbatimit të kontratave të HEC-eve?*
2. *Një listë të kontratave që kanë rezultuar me probleme, deri në këto momente (nëse procesi ende nuk është përmbyllur).*
3. *Informacion lidhur me masat konkrete të marra nga ana e MIE për të gjitha subjektet e rezultuara me probleme.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet portalit *pyetshtetin.al*, ka sqaruar ndër të tjera se: “...Procesi i skanimit ka përfunduar dhe në bazë të rekomandimeve të raportit final të grupit të punës mbi skanimin e kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 07.10.2015, i ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “MIE”), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka përfunduar

*procedurën e njoftimit për 27 shoqëritë koncesionare, të cilat bazuar në skanimin e kryer rezultojnë me shkelje të rënda të kushteve kontraktuale dhe ka filluar njoftimet përkatëse ndaj shoqërive koncesionare për zgjidhjen e kontratës ose vijimin e zbatimit të objektit të kontratës koncesionare.”*

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja, pretendon se: *“...Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje për pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion.”*

Në këto kushte, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Për rrjedhojë, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, Komisioneri, vlerëson se, ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1230/1 prot., datë 13.10.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Në vijim, me e-mail-in datë 20.10.2020, koordinatoresha për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik ka sqaruar ndër të tjerat se: *“...Në Raportin final të Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 49, datë 31.01.2019, janë evidentuar 27 subjekte, të cilat janë në shkelje të rënda të kushteve kontraktore. Në kushtet kur MIE nuk ka bërë publike edhe më herët gjatë njoftimit zyrtar shoqëritë që kanë rezultuar me shkelje të rënda të detyrimeve kontraktuale, vijon të mbahet i njëjti qëndrim se bërja publike e këtij informacioni do të dëmtonte imazhin e subjekteve/shoqërive për të cilat janë konstatuar shkelje të kushteve kontraktuale dhe ndikon në mbarëvajtjen e procedurës së mëtejshme të skanimit/auditimit të kryer. Lidhur me masat konkrete të marra nga Autoriteti Kontraktor, ju bëjmë me dije se në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 250, datë 20.06.2019 “Për zbatimin e rekomandimeve të raportit të grupit të punës mbi skanimin e kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.822, datë 07.10.2015, të ndryshuar”, MIE ka përfunduar procesin e njoftimit të subjekteve që rezultojnë me shkelje të rënda. Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 250, datë 20.06.2019 “Për zbatimin e rekomandimeve të raportit të punës mbi skanimin e kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave” objekt i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822 datë 07.10.2015, i ndryshuar, strukturat përkatëse në MIE janë ngarkuar të vlerësojnë përgjigjet e kontraktorëve dhe të propozojnë zgjidhjen përfundimtare të kontratës, apo fillimin e negociimit për nënshkrimin e shtesës së kontratës për kontraktorët të cilët kanë të justifikuar arsyet e*

moszbatimit të kushteve kontraktore. Sa më sipër, sikurse i është bërë me dije edhe znj.Ndreka me tonën nr. 7261 Prot., datë 14.10.2020 "Kthim përgjigje tuajës për informacion", në bazë të rekomandimeve të raportit final të grupit të punës mbi skanimin e kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, i ndryshuar, MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka përfunduar procedurën e njoftimit për 27 shoqëritë koncesionare, të cilat bazuar në skanimin e kryer rezultojnë me shkelje të rënda të kushteve kontraktuale dhe pas shqyrtimit të përgjigjeve të kontraktorëve, ka filluar njoftimet përkatëse ndaj shoqërive koncesionare."

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesja ka vijuar ankimin nr. 1230/2 prot., datë 22.10.2020, pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ndjekjen e mëtejshme të procedurave në përputhje me ligjin nr. 119/2014, me argumentin se: "...MIE ka refuzuar vënien në dispozicion të këtij informacioni me pretendimin se, bërja publike e këtij informacioni do të dëmtonte imazhin e subjekteve/shoqërive për të cilat janë konstatuar shkelje të kushteve kontraktuale dhe ndikon në mbarëvajtjen e procedurës së mëtejshme të skanimit/auditimit të kryer. Ky pretendim i MIE nuk qëndron, pasi: 1. Kontratat e konçensionit janë kontrata publike të cilat për nga natyra e tyre kanë për qëllim kryerjen e punëve apo shërbimeve, ku subjekti shpërblimin për realizimin e projektit e merr nga e drejta për të shfrytëzuar veprën apo shërbimin. Në çdo rast bëhet fjalë për një kontratë me interes publik dhe si e tillë, procedura e lidhjes, përmbajtja, mënyra e përmbushjes së saj, bëjnë pjesë tek informacionet publike në kuptim të ligjit për të drejtën e informimit. Kontratat konçensionare ofrojnë shërbime apo vepra publike, si të tilla është në të drejtën e publikut që të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm për mënyrën e përmbushjes së këtyre kontratave.

2. Kërkesa lidhur me ecurinë e këtij Raporti është përsëritur disa herë dhe përgjigjia e MIE, ka qenë vazhdimisht që për sa kohë procesi nuk ka përfunduar dhe rezultatet janë paraprake, nuk mund të çenohet imazhi i subjekteve. Duke e pranuar këtë argumentim, kemi mbetur në pritje të përfundimit të punës nga grupi i punës. Tashmë, kjo punë ka përfunduar, sipas informacionit të përcjellë nga vetë MIE, e cila shprehet se referuar Raportit final të Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 49, datë 31.01.2019, janë evidentuar 27 subjekte, të cilat janë në shkelje të rënda të kushteve kontraktore. Pra, aktualisht auditimi që ka filluar që prej janarit të vitit 2019 është i përfunduar. MIE, ka detyrimin që të verë në dispozicion listën e subjekteve të konstatuara me probleme të theksuara. Kujdesi për imazhin e subjekteve tregtare të përfshira nuk përbën shkak ligjor për të refuzuar dhënien e informacionit publik, për sa kohë nuk ka elementë të shpifjes, por është një proces auditimi i kryer nga autoriteti publik kompetent. Interesi parësor që mbrohet në këtë rast është interesi i publikut shqiptar.

3. Referuar nenit 7 pika (ë) të ligjit "Për të drejtën e informimit", një ndër kategoritë e informacioneve të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë paraprake për informacion është edhe: "ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit

publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përkrahimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;" Pra informacioni i kërkuar nga ana jonë me kërkesë, është një informacion që duhet të ishte bërë publik pa kërkesë në fazën e MIE. Si rezultat, pretendimet e ngritura për refuzim të dhënies së informacionit nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Në vijim, me e-mail-in datë 22.10.2020, Autoriteti Publik, ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur, me argumentin se: "Autoriteti Kontraktor, në zbatim të Urdhrit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 250, datë 20.06.2019 "Për zbatimin e rekomandimeve të raportit të grupit të punës mbi skanimin e kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 07.10.2015, të ndryshuar", ka përfunduar procesin/fazën e njoftimit të subjekteve që rezultojnë me shkelje të rënda.

Në zbatim të pikës 7 të Urdhrit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, nr. 250, datë 20.06.2019 "Për zbatimin e rekomandimeve të raportit të punës mbi skanimin e kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.822 datë 07.10.2015, i ndryshuar", aktualisht strukturat përkatëse në MIE janë ngarkuar të vlerësojnë përgjigjet e kontraktorëve dhe të propozojnë zgjidhjen përfundimtare të kontratës, apo fillimin e negocimit për nënshkrimin e shtesës së kontratës për kontraktorët të cilët kanë të justifikuar arsyet e moszbatimit të kushteve kontraktore.

Për sa më sipër, si dhe nisur nga fakti se e gjithë kjo procedurë ligjore (nga njoftimi i fillimit të procedurës drejtuar shoqërive, ne trajtimin e përgjigjeve të kontraktoreve dhe deri në ndërprerjen e njëanshme të kontratës janë pjesë e gjithë procesit të auditimit), do të duhet të jemi si autoritet publik shumë të kujdesshëm në përmbylljen korrekte të këtij procesi, duke synuar kështu mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit që po kryen.

Në këto kushte, si dhe bazuar në gërmën ç, pika 2 e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike."

Nga shqyrtimi i çështjes si dhe qëndrimi i Autoritetit Publik, shprehur me e-mail-et datë 20.10.2020 dhe 22.10.2020 dhe shkresës nr. 7254/1 prot., datë 20.10.2020, konstatohet se kjo çështje është në proces inspektimi dhe auditimi, pra pretendimi i ankueses se ky proces ka përfunduar nuk qëndron.

Për sa më sipër, pas verifikimit të përgjigjeve të Autoritetit Publik dhe fakteve të evidentuara në të, Zyra e Komisionerit, konstaton se, informacioni i kërkuar në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", por në rastin në fjalë e drejta e informimit kufizohet në përputhje me nenin 17, pika 2, shkronja "ç", e ligjit të sipërcituar, në të cilën parashikohet se: "E

*drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike; {...}*”.

Komisioneri vlerëson se, ky kufizim duhet të qëndrojë deri në momentin e përfundimit të procedurave të inspektimit dhe auditimit. Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh interesin që paraqesin procedurat e koncesionit, të cilat janë objekt i veprimtarisë së institucionit, si dhe parashikimet e shkronjës ë), të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri rekomandon bërjen publike nga ana e Autoritetit Publik të këtij informacioni, pas përfundimit të procedurave të sipërcituara. Kjo do t’i shërbente transparencës së veprimtarisë së Autoritetit Publik.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1230 Prot., datë 12.10.2020 të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 26.10.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

